UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA
Rr. George Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Konkluzionet dhe rekomandimet nga Punëtoria " Zbatimi i PSUP 2017-19; arritjet dhe sfidat"

Sharr, 22-23 06. 2018

Pjesëmarrës: 12 njësi akademike (dekanët dhe 1 prodekan),
Menaxhmenti komplet (pa sekretarin dhe një prorektor) dhe
Këshilli Drejtues (6 anëtar).

| Konkluzion | Rekomandim |
|---|---|
| 1. Struktura e brendshme organizative e UP ka diversitet të theksuar (departament- katedra-degë).<br><br>Gjithashtu edhe në administrate (zyra, departamente, njësi). | Publikimi i Raporteve vjetore të NjA sipas Statutit<br>Raportimi i NjA mbi progresin e punës- në baza 3 mujore<br>Të bëhet **organizimi i brendshëm sipas Statutit sipas Rregullore për Sistematizimin e Vendeve të Punës** |
| 2.Problemet e funksionimit të instituteve dhe njësive shkencore hulumtues dhe profesional (qendrat)- mungon transparenca, raportimi financiar, shumica duket se janë joefektive, Paqartësi legale të funksionimit, financimit (p.sh. instituti i FIM, institutet paraklinike të FM) etj. | Raport në lidhje me të gjitha **institutet/ qendrat në kuadër të UP-së**.<br>Rishikimi i rregullores së instituteve/qendrave për funksionalizimin e tyre<br>Promovimi i instituteve/qendrave për gjenerimin e fondeve dhe ofrimin e shërbimeve për palët e treta.<br>Promovimi i hulumtimeve dhe publikimeve shkencore nga institutet. |
| 3. Më pak se gjysma e NjA kanë planet strategjike: disa i kanë në skadim, disa janë në hartim e sipër. | **Të zhvillohet dinamik për hartimin e dokumenteve strategjike** nga të gjitha NjA në pajtueshmëri me PSUP 2017-19 |
| 4. Mungon promovimi i vlerave, potencialit dhe arritjeve të NjA të veçanta por edhe vet UP si entiteti akademik Nr 1. në hapësirën shqipfolëse. | **Forcimi i PR të në të gjitha NjA dhe në UP, online** deri në fund të vitit 2018 (punësim dhe trajnim i stafit). |
| 5. Stafi akademik ende në mungesë, por edhe ai ekzistues jo i shfrytëzueshëm 100% në | Të respektohen kontratat e punës.<br>Hartimi i rregullores për kushtet e angazhimit shtesë jashtë UP-së. |

| | |
|---|---|
| kuadër të përgjegjësive statutare e ligjore (kontratat e punës: 1+ ½). | Të bëhet një analizë nga **Auditori i Brendshëm** dhe **Plan veprimi nga Menaxhmenti** për koncentrimin e energjisë së resurseve njerëzore brenda UP-s<br>Zhvillimi i kapaciteteve humane në pajtim me objektivat e PSUP dhe të NjA..<br>Avancimi i kritereve për punësimin e stafit për herë të parë (Gjuha e huaj kriter eliminues) |
| 6. Nuk ka planifikimi individual vjetor të stafit. Si pasojë nuk ka vlerësim të performances së stafit akademik në raportin: mësimdhënie-hulumtime- projekte; dhe si rezultat mungon mbështetja e bazuar në merita (përfshirë avancimin). | Zhvillimi i kritereve dhe procedurave dhe për **një sistem të matshëm dhe efikas të performancës së stafit akademik** (profesorëve, asistentëve).<br>Formimi i komisioneve profesionale për mentorim të mësimdhënies dhe raportim vjetor nëpër NjA<br>Te stafit i angazhuar të përfillet performanca paraprake (nëse ka qenë). |
| 7. Numri i lëndëve për normën e profesorëve është i madh (për 6 normë: 3 lëndë x 2 orë në Semester + po aq në semstrin tjetër).<br>Kur kësaj i shtohet edhe mbinorma… | **Të rritet numri i orëve kontaktuese** të stafit akademik përmes rritjes së orëve të normës vs. zvoglimit të numrit të lëndëve për profesor (përmes punës në grupe të vogla).<br>Kjo siguron prezencën por edhe rrit cilësinë.<br>Rishikimi i Rregullores për të ardhura. |
| 8. Mungon stafi administrativ sidomos te NjA më të mëdha në numër studentësh (FE, FJ, FF, FEdu).<br><br>Kapacitetet profesionale të administratës tepër të kufizuara | **Konkurset për staf të jenë më efektive** dhe bazuar në **nevojat/kërkesat e NjA**.<br>Raport për identifikim për shkaqet e ngecjeve të punësimit të administratës.<br>**Shtimi i kompetencave të dekanëve** mbi administratën e NjA përkatëse.<br>Të mbështetet administrata **në ngritjen e kapaciteteve,** por me plan të zyrave e më pas atë individual zhvillimor sipas organogramit. |
| 9. Mungesë e madhe infrastrukturore për studim dhe aktivitetet mbështetëse për student. Shumica e fakulteteve mungesë sallash, laboratoresh e disa edhe komplet objekteve (FSHMN) | **Zgjerimi i hapësirave** të reja për punë: FSHMN, F. Ekonomik, FEFS,<br>Të qartësohen çështjet e **qartësimit të pronësisë mbi infrastrukturën** (p.sh. rasti i sallës 1 Tetori) .<br>Zhvillimi i E-Bibliotekës<br>Themelimi i **Zyrës për infrastrukturë** brenda UP-së. |
| 10. Buxheti i centralizuar<br>Buxheti në NjA po ka vështirësi në zbatim shkaku i procedimit të kërkesave sidomos për | **Decentralizimi i buxhetit për NjA** (bartje e përgjegjësisë dhe llogaridhënies) |

| | |
|---|---|
| pajisje dhe investime kapitale- deri sa të gjitha NjA të dërgojnë.<br>Është hartuar Manuali për financa<br>Kërkesa e shpeshta KD nga NjA si pasojë e mos-planifikimit me kohë.<br>Auditimi i brendshëm- me vështirësi nga mungesa e stafit | Të përgatitet një **Rregullore e veçantë për procedurat e rrjedhave të vijave buxhetore** në UP (afatet procedurale-kohore të alokimeve financiare) si dhe rregullon rastet kur KD të merret me financat e paplanifikuara .<br>Rishikimi i rregullores për të ardhura<br>Të implemtohet FAITH!! |
| 11. Nuk ka mbështetje të mjaftueshme për hulumtimet, publikimet dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore | **Rregullore për mbështetjen e publikimeve**, botimin e teksteve nga Këshilli Botues dhe Konferencave<br>Promovimi i publikimit **të revistave shkencore me ISSN** nëpër NjA |
| 12. Mungon një analizë e ndarjeve buxhetore bazuar në raportin njësi-student.<br>Tarifat e studimit dhe shërbimeve janë fikse ndërsa që shpenzimet e studimit gjithnjë në rritje. | Qëndrueshmëria financiare e UP-së duhet të jetë pikë orientuese strategjike.<br>Të inicohet procesi i **planifikimi financiar njësi-student** dhe të rishikohen zbrazëtirat financiare që mbeten nga tarifat aktuale të studimit dhe shërbimeve.<br>Të analizohet **mundësia e studimeve me vet-financim** (ka ekzistuar në të kaluarën në F. e Mjekësisë).<br>FAITH- të implementohet!! |
| 13. Programet në masë të madhe të konsoliduar, por pezullimi i 23 programeve dhe mosakreditimi i disa tjera- shqetësuese.<br>Programet e përbashkëta- shumë të kufizuara<br>Programet në gjuhën angleze sipas PSUP- të kufizuara. | **Të ri-shikohen/pezullohen** që programet që nuk i kërkon tregu, dhe të koncentrohen resurset njerzore në ato ku janë nevojat dhe ekspertiza.<br>Zhvillimi i **programeve sipas trendëve bashkëkohore nga vendet e BE**, me theks të posaçëm programet në gjuhen angleze<br>Të punohet në **zhvillimin e programeve të dyfishta**. |
| 14. Legjislacioni dhe baza institucionale për sigurimin e cilësisë (rregullore, manual, procedura, zyrat) është adekuate. Por cilësia e studimeve ende është për tu dëshiruar | Promovimi i mësimdhënies metoda bashkëkohore.<br>**Të sigurohet kalimi nga cilësia në letër në atë në rezultatet e të nxënit.** |
| 15. Legjislacioni dhe Statuti i UP ka dilema dhe paqartësi në raport me: zhvillimet akademike (avancimet), strukturat organizative (FM/UP- SHSKUK/ MSH); proceset dhe procedura tjera akademike e administrative. | Me aprovimin për Arsimin e Lartë për përgatitjen e Statutit e UP të organizohen punëtori intensive.<br>**Komisioni Statutar** të aktivizohet më shumë në interpretimet statutare.<br>Themelimi dhe funksionalizimi i **Zyrës Ligjore** të UP-s. |

| | |
|---|---|
| | Mbështetje me **rregullore për procesin e ndërkombëtarizimit** (mobiliteti akademik). |

**Përfundim:** të organizohen takime të tilla KD-Rektorat-Dekan (në 3 muaj) për temat e caktuara: zhvillimi i cilësisë, hulumtimi dhe kërkim, mësimdhënia, buxheti dhe infrastruktura dhe fushat tjera strategjike të PSUP 2017-19.